



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA  
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 294 Dt. 01.05.2023

PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së, Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023), si dhe në bazë të Ankesës së KB Trepça të datës 01.05.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 01.05.2023 merr këtë:

## VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME ankesa e KB Trepça e datës 01.05.2023;
- II. MIRATOHET ankesa e KB Trepça e datës 01.05.2023;
- III. ANULOHET vendimi i Komisionit të Garave i datës 01.05.2023 që ka të bëjë me caktimin e kalendarit të zhvillimit të finaleve të Play-off.
- IV. VENDOSËT që përparësinë e terrenit vendës në finalen e Play-offit do ta ketë KB Trepça.
- V. URDHËROHET Komisioni i Garave të caktojë kalendarin e zhvillimit të finaleve konform këtij vendimi.

## ARSYETIM

Me datë 01.05.2023, Komisioni Arbitrar, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e KB Trepça të datës 01.05.2023 (tash e tutje: 'Ankesa'). Kjo e fundit ka të bëjë me vendimin e Komisionit të Garave të FBK-së të datës 01.05.2023 (tash e tutje: 'Vendimi'), lidhur caktimin e kalendarit të zhvillimit të ndeshjeve finale të Play-off të Prince Caffè Superliga .

Në këtë kuadër, Komisioni Arbitrar ka mbajtur takim më 01.05.2023, dhe ka trajtuar Ankesën e KB Trepça. Në takim kanë qenë prezent: Korab Sejdiu (Kryetar i Komisionit Arbitrar), Lulzim Fushtica (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Fidan Hamiti (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

## Kosovo Basketball Federation

Supported by:



TEB

General Sponsor:

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, KB Trepça në Ankesë sfidon vendimin e Komisionit të Garave të FBK-së të pranuar përmes postës elektronike më datë 01.05.2023, sipas së cilit Komisioni i Garave konfirmon kalendarin të zhvillimit të finaleve duke i dhënë përparësinë e terrenit vendës në finalet e Play-offit finalistit KB Peja.

Komisioni Arbitrar gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023), dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyt në vijim.

Neni 9.2.1. i Propozicioneve të Garave, thotë në pjesën përkatëse: *'Në rast të eliminimit të ekipit më lartë të plasuar, skuadra më poshtë e plasuar zë vendin e asaj skuadre.'*

Më tutje, i njëjti nen, më poshtë thotë: *'Përparësinë e terrenit vendës e ka ekipi që ka qenë më mirë i ranguar në edicionin e rregullt dhe luan si vendas në ndeshjet 1 dhe 3 dhe ndeshjen eventuale 5.'*

Një lexim i arsyeshëm i këtyre dy dispozitave, në përputhje me qëllimin e hartuesit dhe me praktikën e zbatimit të tyre në raste paraprake, është më se e qartë për Komisionin Arbitrar se përparësia e terrenit vendës i takon ekipës e cila ka mposhtur ekipën e ranguar më së larti gjatë edicionit të rregullt të garave. Rrjedhimisht, në rastin konkret, KB Trepça ka përparësinë e terrenit vendës.

Për më tepër, ky vendim është në përputhje edhe me praktikën paraprake, konkretisht në edicionin 2020-21, ku e drejta e përparësisë së terrenit vendor në serinë finale i është dhënë KB Peja, si ekip që ka mundur liderin e tabelës gjatë edicionit të rregullt.

Rrjedhimisht, Komisioni Arbitrar duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

### Komisioni Arbitrar:

Fidan Hamiti  
Anëtar

Korab Sejdiu  
Kryetar

Lulzim Fushtica  
Anëtar

Prishtinë, 1 Maj 2023

### Vendimi i dërgohet:

- KB Trepça
- KB Peja
- Komisionit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së



### KËSHILLË JURIDIKE:

*Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit Arbitrar kanë të drejtë të ankesës te Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.*

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

